



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV

Sesioni pranveror

Komisioni për Legjislacion

Mbledhja nr. 17

Prishtinë, më 25 korrik 2011, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-302

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për Legjislacion

Në mbledhje morën pjesë: Arben Gashi – kryetar, Ardian Gjini, Mufera Şinik, Halit Krasniqi, Haki Demolli, Albulena Haxhiu, Armend Zemaj dhe Jasmina Zhivković.

Munguan: Behar Selimi, Arsim Bajram dhe Ibrahim Makolli.

Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë: Guido Oestreich, Blerta Ukmata, Naim Hajdari dhe Floriana Shala – EULEX, Lumniye Murati – ZPRK, Lumturie Beka – Kosova Sot, Shqipe Osmani – Bota Sot, Arben Rexhepi – Radio -Dukagjini, Mertita Stublla Emini- USAID, Astrit Hoti – KGJK, Sali Mustafa - ALSAT, Natyra Kasumaj – KDI, Eshref Vishi – Kuvendi Kosovës dhe Fixhrije Dragaj - praktikante.

Nga Stafi i Komisionit për Legjislacion: Idriz Tahiri dhe Visar Krasniqi.

Mbledhjen e kryesoi: Arben Gashi, kryetar i Komisionit.

Rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës,
2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve më 5 dhe 11.07. 2011,
3. Shqyrtimi i shkresës së Këshillit Gjyqësor të Kosovës për emërimin e anëtarëve të Këshillit,
4. Shqyrtimi i përfundimit të Kryesisë nr. 04-P-039/k i datës 5 korrik 2011,
5. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L- 030 për përgjegjësin e personave juridikë për vepra penale,
6. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L- 031 për bashkëpunimin juridik ndërkombëtar në çështjet penale,
7. Të ndryshme.

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 22. 6. 2011

Kryetari konstatoi se Komisioni e miratoi procesverbalet nga mbledhjet më 5 dhe 11.07. 2011, pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i shkresës së Këshillit Gjyqësor të Kosovës për emërimin e anëtarëve të Këshillit

Kryetari, pasi i njoftoi me shkresën e Këshillit, foli për përbërjen aktuale të tij dhe për problemet rreth funksionimit dhe zgjedhjes së anëtarëve. Në vazhdim foli për bazën juridike, për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit, si dhe anëtarët nga radhët e komuniteteve, duke ju referuar neneve të Kushtetutës dhe Ligjit për Këshillin Gjyqësor. Ai tha se kemi tri qëndrime, qëndrimi i parë është që të lihet kështu dhe të veprohet siç është vepruar deri tani, mirëpo ne kemi një ligj për Këshillin Gjyqësor që nuk duhet të lihet ashtu. Mendimi i dytë është që anëtarët, të cilët janë zgjedhur në procedurën e paraparë me këtë ligj thjesht të miratohen në seancë, sepse Kushtetuta parasheh që të kalojë në Komision dhe të miratohen në seancë. Kurse mendimi i tretë është që ne të marrim edhe pak kohë dhe të konsultohemi me institucione ndërkombëtare, pikërisht me ICO- në për të parë se cili është mendimi i tyre.

Haki Demolli- Theksoi se është mirë të mos ngutemi, sepse këtu kemi tri akte ligjore, mirë është ta analizojmë.

Ardian Gjini – U pajtua me parafolësin që për Komisionin në mbledhjen e ardhshme vijnë dy opsione. Atëherë vendosim në mbledhjen e ardhshme të Komisionit.

Armend Zemaj – U pajtua me parafolësit që ta kemi një kohë për konsultime, mendoj që kryetari duhet ta ketë një takim me kryetarin e Këshillit Gjyqësor, që ta kemi një pasqyrë më reale dhe mos ta zvarrisim më tutje.

Komisioni lidhur me këtë pikë vendosi që të shqyrtohet në një mbledhje të radhës.

4. Shqyrtimi i përfundimit të Kryesisë nr. 04-P-039/k i datës 5 korrik 2011

Kryetari - Theksoi se drejtorit të Agjencisë Kundër Korrupsioni i ka kaluar mandati dhe në mbledhjen e kaluar, si Komision, kemi marrë vendim që të shpallet konkursi. Konkursi është shpallur, kemi çështjen e ushtruesit të detyrës, kush mund ta ushtrojë detyrën e drejtorit deri në zgjedhjen e drejtorit të ri? Kemi disa mundësi që t'i referohemi Ligjit për Shërbyesit Civilë, në kuadër të këtij ligji të procedojmë me këtë çështje. Ushtrues i detyrës nuk mund të emërohet më gjatë se tre muaj, në rast se i referohemi këtij ligji, neve na mbetet që t'i kërkojmë njërit nga tre drejtorët e agjencisë ta ushtrojë këtë detyrë.

Halit Krasniqi- Shprehu mendimin se është më e drejtë që drejtori aktual ta ushtrojë detyrën drejtorit, deri në zgjedhjen e drejtorit të ri.

Ardian Gjini- Shprehu mendimin se Komisioni sot duhet të marrë vendim për shkak se e dimë që është institucion i rëndësishëm Agjencia kundër Korrupsionit dhe se nuk është ushtruesi i detyrës aq me rëndësi sa ne t'i mbajmë 10 mbledhje.

Albulena Haxhiu- Tha se pasi që jemi në një situatë të tillë, jemi para një akti të kryer dhe shpresoj që të mos na ndodhë në të ardhmen, atëherë unë propozoj që t'i referohemi ligjit për shërbyesit civilë.

Armend Zemaj- Tha se po na përsëritet e njëjta gjë për të cilin kemi debatuar edhe në takimin e kaluar, sa për informim, unë pata dhënë vërejtje pse është vonuar Kryesia e Kuvendit në shpalljen e konkursit. Ligji mbi Agjencinë Kundër Korrupsion është ligj special dhe faktikisht nuk e ka paraparë dispozitën e zëvendësimit të drejtorit, duke menduar në ushtrimin e lirisë së plotë. Prandaj, ne, duhet t'i referohemi të vetmit ligj, që është ligji mbi shërbyesit civilë, pasi që drejtorët janë shërbyes civilë, e kam thënë edhe në mbledhjen e kaluar dhe për nga rëndësia e kam cekur se Departamenti i hetimeve është departamenti më i rëndësishëm në Agjencinë Kundër Korrupsion, mirëpo cili do që të jetë nuk ka ndonjë problem.

Haki Demolli- Duke u ndërlidhur me diskutimet e parafolësve tha se ligji mbi shërbyesit civilë, si duket është ligj më i përafërt që të dalim nga kjo situatë, por nuk jam për atë që të merremi edhe shumë mbledhje me këtë çështje. Konkursi është shpallur dhe së shpejti do kemi në mënyrë legjitime drejtorin.

Kryetari konstatoi se Komisioni për Legjislacion njëzëri nxori këtë:

Përfundim

Në mbështetje të Ligjit të shërbimit civil nr. 03/L-149, caktohet drejtori i Departamentit të Administratës së Agjencisë Kundër Korrupsionit ushtrues i detyrës së drejtorit të Agjencisë.

5. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L- 030 për përgjegjësinë e personave juridikë për vepra penale

Kryetari konstatoi se Komisioni për Legjislacion lidhur me këtë pikë njëzëri nxori këtë:

Përfundim

1. Formohet Grupi i punës për shqyrtimin e Projektligjit për përgjegjësinë e personave juridikë për vepra penale, në këtë përbërje: Behar Selimi - kryesues, Albulena Haxhiu, Haki Demolli dhe Jasmina Zhivkoviq - anëtarë.

6. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L- 031 për bashkëpunimin juridik ndërkombëtar në çështjet penale

Kryetari konstatoi se Komisioni për Legjislacion lidhur me këtë pikë njëzëri nxori këtë:

Përfundim

Formohet Grupi i punës për shqyrtimin e Projektligjit për bashkëpunim juridik ndërkombëtar në çështjet penale, në këtë përbërje: Armend Zemaj - kryesues, Albulena Haxhiu dhe Jasmina Zhivkoviq – anëtarë.

7 . Të ndryshme

Lidhur me këtë pikë nuk kishte diskutime.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetar i Komisionit

Arben Gashi